



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit janar është realizuar monitorimi i 600 mësimdhënësve të përfshirë në trajnim në kuadër të programit të MKLSH-së. Monitorimet janë bërë në shumë shkolla të Prishtinës, Hajvalisë, Podujevës, Mitrovicës, Vushtrisë, Skenderajt, Pejës, Junikut, Glllogjanit, Malishevës, Krushës së Madhe, Prizrenit, Suharekës, Dragashit, Kaçanikut, Ferizajit, Shtimes, Vitisë dhe Gjilanit. Mësimdhënësit e përfshirë në trajnim kanë qenë të paralajmëruar për monitorim dhe trajnerët kanë raportuar se nuk kanë pasur problem gjatë realizimit të tyre. Orët e monitoruara do të analizohen më 10 shkurt kur do të mbahen dhe takimet gjysmë-ditore në 19 qendra të Kosovës.

■ Po ashtu më 3-5 janar 2008 në kuadër të MKLSH-së është mbajtur seminari i tretë dhe i katërt me përfaqësues të MASHT, KEC dhe disa mësimdhënës të Shkollës Fillore “Zenel Hajdini” në Prishtinë. Modulet e prezantuara gjatë seancave ishin “Leximi, shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë” si dhe “Teknika tjera për zhvillimin e mendimit kritik”.



Nga fletë vlerësimet shihet se pjesëmarrësit kanë qenë shumë të kënaqur me materialet e prezantuara. Trajnimi i radhës për këta pjesëmarrës do të mbahet më 4-6 shkurt 2008.

Hap pas Hapi

■ Gjatë janarit janë intensifikuar monitorimet e mësimdhënësve të cilët punojnë me metodologjinë Hap pas hapi. Këto monitorime bëhen me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës. Monitorimet u organizuan si në shkolla fillore ashtu edhe në Institucione parashkollore.

■ Me 17 janar në kopshtin SOS Kinderdorf, u mbajt takimi i radhës me “Kontakt personat”. Në këtë takim u diskutua për planet e aktiviteteve me fëmijë gjatë këtij viti shkollor. Gjithashtu, u dhanë disa ide rreth planifikimit të disa temave, që do të jenë të përbashkëta për grupmoshat 5-6 vjeç.

■ Në kuadër të planit të projektit i cili zhvillohet në bashkëpunim me MASHT, u organizuan edhe dy trajnime në Pejë dhe Mitrovicë. Në Pejë u mbajt trajnimi bazik për klasën e parë me 4-6 dh 12-13 janar ku morën pjesë 33 pjesëmarrës nga shkolla të rajonit të Pejës, përkatësisht nga Klina, Istogu dhe Deçani.

Në Mitrovicë me datat 2-4 shkurt u mbajt trajnimi për klasën e tretë. Në trajnim morën pjesë 35 pjesëmarrës nga rajoni i Mitrovicës.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Janari 2008 është muaji i fundit i vitit të parë të projektit “Shoqëria Civile

për Pjesëmarrje të shtuar në Arsim”. Të gjitha aktivitetet e parapara për vitin e parë u përfunduan me sukses.

Në kuadër të këtij projekti është paraparë të trajnohen 500 mësime nga ana e KEC, KAHCR dhe SBASHK. Gjatë janarit u përfundua Cikli i parë – 7 grupe të trajnimit.

■ Gjithashtu, në muajin janar u mbajt edhe punëtorja për Zhvillimin e Politikave. Punëtorja u mbajt me datat 8,9 janar, 2008, ku morën pjesë 12 përfaqësues, të cilët e përbejnë Grupin punues për hartimin e politikave. Këtë punëtori e mbajtën Dukagjin Pupovci dhe Jehona Shala.

Anëtarët e grupit punues u ndanë në dy grupe për hartimin e dy politikave:

a) Politika për rritjen e gjithpërfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor përmes formave alternative të edukimit parashkollor dhe b) Politika për parandalimin e braktisjes së shkollimit. Pas punëtorisë grupet kanë vazhduar punën për zhvillimin e këtyre politikave.

Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim Faza e Dytë

■ Në ditët e para të vitit 2008 filloi faza e dytë e Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA 2). Me financim të Bankës Botërore, gjatë dhjetë muajve vijues rreth 90 shkolla fillore dhe të mesme nga 11 komuna të Kosovës do të përfitojnë përkrahje financiare për implementimin e projekteve shkollore që kanë për qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim përmes ngritjes së cilësisë së procesit arsimor. Përveç faktit se projektet shkollore do të duhet të fokusohen në përmirësimin e cilësisë, nga PPPA 2 do të mund të përfitojnë edhe 5 nga 11 komunat e përfshira, të cilat do të kenë rastin të realizojnë projekte për

përmirësimin e cilësisë në nivelin komunal.

Roli i KEC është ofrimi i ndihmës profesionale shkollave në hartimin e planeve zhvillimore të shkollave dhe të projekteve shkollore, si dhe mbikëqyrja e zbatimit të projekteve. Gjatë muajit janar, Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore i MASHT, në bazë të propozimeve të komunave, e ka bërë për zgjedhjen e 30 shkollave të para që do të marrin pjesë në këtë projekt.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Me përkrahjen e Fonacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), e si rezultat i marrëveshjes me MASHT, këtë vit filloi edhe projekti për monitorimin e implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim, të aprovuar vitin e kaluar nga MASHT. Qëllimi i këtij projekti është të hartohet një kornizë për monitorimin e kësaj strategjie, si dhe të angazhohet shoqëria civile të përcjellë për së afërmi zhvillimet në këtë fushë.

Projekti për mbështetjen dhe funksionalizimin e Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie të UP-së.

■ Në datat 20-24 janar, kishim një ndër ngjarjet kryesore të tërë projektit për mbështetjen e QPM-së. Gjatë këtyre ditëve në hotelin “Palas” në Mitrovicës u organizuan prezantimet e kurseve të përgatitura nga trajnerët e QPM-së. Në fakt, këto kurse ishin përgatitur gjatë aktiviteteve shumë të dendura grupore të trajnerëve tanë për zhvillimin e kurseve, sipas detyrave të pranuar gjatë vizitës

studimore në Gjermani në muajin dhjetor të vitit 2007.

Të gjithë pjesëmarrësit ishin ndarë në grupe për të zhvilluar kurse në tema të ndryshme si: shkathtësitë e prezantimit, metodat aktivizuese, mjetet e prezantimit, etj.

Të gjitha detyrat e përgatitura dhe të prezantuara nga trajnerët u vlerësuan shumë pozitivisht nga mentorët gjermanë të institucionit partnerë nga Universiteti i Nyrnbergut.

Një kohë e konsiderueshme gjatë prezantimeve iu kushtua diskutimit dhe informatave kthyese nga pjesëmarrësit. Këto prezantime janë pjesë e një programi të tërësishëm që do të pasohet nga avancimi i kurseve dhe prezantimet e pavarura me qëllim të finalizimit duke u certifikuar si Trajnues i QPM-së nga partnerët gjermanë.

Ngjarje të tjera do të vijojnë gjatë muajve prill, maj dhe qershor të këtij viti kur edhe pritet të përfundojë i tërë programi.

Access Microscholarship Program

■ Në muajin janar, grupi i nxënësve nga Prizreni kanë pasur një aktivitet social. Aktiviteti social është zhvilluar në Prevallë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që nxënësit të njihen edhe me sportet e dimrit. Përveç aktiviteteve sportive, ata gjatë tërë kohës janë munduar që të komunikojnë në gjuhën angleze, në mënyrë që edhe aktivitetet e tilla sociale të kenë karakter edukativ. Grupi i Prizrenit mësimin e kanë filluar që në fillim të janarit, pasi që semestrin e kaluar kanë pasur disa vonesa me mësim.

Ndërsa, dy grupet e Prishtinës, mësimin e filluan në kohën e paraparë sipas projektit. Edhe grupet e Prishtinës, gjatë muajit shkurt do të organizojnë ndonjë aktivitet social.

Përgatiti: Petrit Tahiri